



UNIVERSITY OF PRISHTINA  
“HASAN PRISHTINA”  
FACULTY OF PHILOLOGY

LENDITA KRYEZIU

“TED Talks as means of improving listening and  
speaking skills in teaching English and corpus  
analysis”

(Doctoral Dissertation)

Prishtine, 2019

UNIVERSITETI I PRISHTINËS  
FAKULTETI I FILOLOGJISË  
NIVELI I DOKTORATËS

LENDITA KRYEZIU

“TED Talks as means of improving listening and  
speaking skills in teaching English and corpus  
analysis”

PUNIMI I DOKTORATËS

Mentore:

Prof. Dr. SHYKRANE GËRMIZAJ

Prishtinë, 2019

## **SUMMARY**

The doctoral dissertation entitled: “TED talks as means of improving listening and speaking skills in teaching English and corpus analysis” treats the use of TED Talks with the students of the department of English Language and Literature of the Faculty of Philology, the University of Gjakova for a period of four semesters. The usage of TED Talks helps in studying and researching strategies for improving listening and speaking skills as well as acquiring English as a foreign language. In this work, the transcripts of students’ TED Talks based speeches have been analyzed for discourse and error analysis.

TED Talks are widespread around the world. They are presented to the audience carrying the logo with the sound of the water drops falling into the ocean which resonate with pieces of information dropping into the sea of knowledge, so vast and profound. The background of the stage is full of colors which symbolize lights that illuminate human minds and warm human hearts. In every beginning there is an applauding, a rhythmic synchronic and well deserved applaud for all the people standing in the podium, taking the floor, disseminating ideas, knowledge and experience. Throughout the speeches, a laughter triggered by occasional humor at the speakers’ or audience’s expense with the aim of breaking borders and making connections between them can be heard.

In TED talks people with creative ideas and people who had success in different fields present, they bring out their linguistic background as well due to the fact that they come from different ethnic, language and education backgrounds, represent both genders and different age groups . Here, the importance of using this corpus as discourse analysis arises in order of finding out more about language varieties, body language, and differences that exist in language regarding gender, age and education.

Starting from this issue, TED Talks have been used as materials for practicing listening skills as well as serving as a sample for preparing and delivering speeches in front of the auditorium. The more extrovert students have prepared their speeches based on the TED format regarding the topics as well as content and duration.

Students speeches contain a wide range of topics such as: Listening to the others; Marry in haste repent at leisure; What it takes to appreciate things we take for granted; Depression, the bruise

we pretend not to see; When you have many problems and anxiety is the least one; True leaders don't create followers, they create more leaders; Become your own doctor; The public speaking and the fear of it; Domestic violence and abuse can happen to anyone; Some parts of my life; Umm... Sorry, I forgot; You are what you eat; It is all in your hands; Men are from Mars, women are from Venus; Technology changes humanity; We have only one planet to live in. Handle it with care!

These 16 speeches, delivered by 13 women and 3 men have the duration of 182,35 minutes, in total three hours, starting from the shortest one, 4 minutes up to the longest one which is 30 minutes. The transcripts of the speeches contain 41 pages with 23.372 words in total which have been summarized and analyzed for discourse and error analysis. The speakers have written journals regarding topic selection, speech preparation and its delivery. The students who were present in the auditorium have provided feedback on these speeches. Moreover, the interpretation of non-verbal language has been done.

The control group who are more introvert have been given the opportunity to write their speeches. The students were also instructed to have an idea which is worth spreading to the world. They were advised as well to share a remarkable story, journey, enthusiasm, or talent they are passionate about. Suggestions to speak from the heart, to be authentic and vulnerable while revealing their failures and weaknesses were given to them at the same time. Most importantly, students were advised to have something of substance to say that will impact, inspire or help the others. Students have shared many personal and sad stories like different problems, violence, anxiety, fear, depression, stage fright, gender inequality, poverty, unemployment etc.

The research has manifold aims. Besides investigating the influence of these talks in Second language acquisition, the other aim is to analyze the language used in these talks in order to identify the differences according to gender, age, education and language background. The first aim of this doctorate thesis is to research on the issue of using TED Talks in Second Language acquisition as a listening activity. The perception of language by the side of students when speakers differ by gender, age education and whether English is their native language or not. The second aim is researching whether TED talks used as listening activities help students in improving speaking skills when delivering a speech or handling a presentation. The third aim is

investigating discourse used in these talks. Researching as well the varieties of English when spoken by presenters belonging to both genders, different age, and education.

The oratory is always important in gaining support and power. In language acquisition as well, speaking is one of the greatest challenges to overcome, because a man can learn in silence, listen to the others speaking but the most difficult activity is speaking as a performance skill. Having all these reasons in mind, researching the use of TED talks as listening activities will enable the learners in understanding language, retrieving it and using samples as facilitating tools for speaking critically and argumentatively since the majority of the material introduced in these talks is argumentative discourse.

In this dissertation, these following hypotheses have been proposed: TED talks are significant language tools in facilitating listening comprehension in second language acquisition; TED talks serve as a scaffolding sample for improving speaking abilities during student's presentations; TED talks are used as visual devices that will enable learners acquire some information about posture, body language and interaction with the audience during presentations; TED talks serve as listening assessment for measuring students' comprehension of second language; Students perception of language differs regarding speaker's age, gender, background language and education; There are differences in language varieties as regards to age, gender and origins.

Classes have been divided into experimental and control groups in order to measure the impact of these video recordings as an aid for listening and speaking skills and then, the results have been analyzed and compared. Presented TED talks have been processed in that way that comprehensive tests have been compiled and the classes have been assessed.

Regarding speaking skills, the students have studied samples of TED Talks and have prepared their speeches according to the specific pattern. The research includes a wide specter of videos of both genders, different ages, different educational background and whether the speaker is native or non-native speaker of English.

Another important issue to be observed is the impact of these talks as a listening activity in second language acquisition proving that students who are exposed constantly to these materials show better results in language learning after being evaluated for language competence.

Questionnaires as measuring instruments for qualitative and quantitative data have been delivered to the respondents of the research and the data have been closely analyzed. Observation protocols have been used as means of observing students during listening and speaking skills in the classroom. Different tests have also been compiled using TED talks for listening comprehension and the students have been assessed in language acquisition.

All the issues mentioned above have been elaborated and examined with the purpose of finding out the outcomes from the questionnaires, observation, recordings and testing. An attempt to present the data and to interpret them on charts and different statistics has been made in order to present the real situation in language learning, language teaching and metacognitive knowledge on language.

Being of qualitative and quantitative nature, this doctoral thesis has a considerable significance in the field of discourse analysis, gender studies, language acquisition and teaching methodology.

This doctoral dissertation consists of seven chapters. The first chapter introduction, aims and the importance of the study; Research Hypotheses and questions; Rationale of the study; The emergence of teaching language to students.

The second chapter includes the literature review where the importance of listening, speaking and writing skills in SLA according to different approaches are treated; Listening process and procedures, Teaching as part of the research as well as sociolinguistic issues like language and gender, discourse and error analysis.

Third chapter includes the research methodology, the processes, timeline and the measuring instruments of the research.

Fourth chapter includes the research data analysis and interpretation starting with the summary of the speeches; Discourse and error analysis; Students' feedback; variety of written speeches, interpretation of speakers' non-verbal language and the usage of TED Talks for writing summaries as post-listening activities.

Fifth chapter consists of TED Talks used as Listening Comprehension Tests; The Audio Listening Comprehension Tests used by the control group.

Sixth chapter includes the interpretation of questionnaires whereas the seventh chapter includes the conclusion that derives from Students' TED based speeches; Discourse and error analysis; Students' feedback; Interpretation of speakers' body language; Students' written speeches; Speakers' journals on pre and post speaking experience while preparing the speech; TED Talks are very significant for improving listening comprehension; Audio Talks for listening comprehension; Using TED Talks in writing summaries as Post-Listening Activity; The students' relation to the topics they have chosen or liked; Questionnaires; Students' preferences regarding age, gender and origin; TED talks serve as a sample for improving speaking; TED talks as visual for non-verbal language. The dissertation also has the appendix starting from the page 244 up to 262.

**Key words: TED Talks, listening skills, speaking skills, writing skills, language acquisition, discourse analysis, nonverbal language.**

## PËRMBLEDHJE

Në punimin e doktoratës me titull: ‘TED Talks’ si mjete për përmirësimin e shkathtësisë së dëgjuarit dhe të folurit në mësimin e anglishtes dhe analiza gjuhësore e korpusit është zbatuar përdorimi i TED Talks me studentët e degës së gjuhës dhe letërsisë angleze të Fakultetit të Filologjisë së Universitetit të Gjakovës në periudhën prej katër semestrave. Përdorimi i TED Talks ndihmon në studimin dhe hulumtimin e strategjive në përmirësimin e të dëgjuarit dhe të folurit, si dhe përvetësimin e gjuhës angleze si gjuhë e huaj. Në këtë punim është bërë edhe analiza e transkripteve të fjalimeve të studentëve në formatin e TED Talks si analizë diskursi dhe analizë e gabimeve.

Fjalimet TED janë të përhapura në mbarë botën. Ato i prezentohen publikut duke bartur logon me tingullin e pikave të ujit që bijnë në oqean që asocion në copëza të informatave që bijnë në detin e gjerë e të thellë të diturisë. Prapavija e skenës është plot ngjyra që simbolizojnë dritën që ndriçon mendjen e njerëzve dhe ngroh zemrat e tyre. Në çdo fillim është duartrokita, një duartrokite ritmike e sinkronizuar dhe e merituar për të gjithë ata njerëz që qëndrojnë në podium, shpërndajnë ide, dituri dhe përvojë. Përgjatë fjalimeve, dëgjohet aty-këtu ndonjë e qeshur e nxitur nga humori në llogari të folësit apo audiencës, me qëllim që të thyhen kufijtë dhe krijohen lidhje në mes të folësit dhe publikut.

Në fjalimet TED prezantojnë njerëzit me ide kreative dhe njerëzit që kanë pasur suksese në fusha të ndryshme. Ata sjellin kulturën e tyre gjuhësore për arsye se ata kanë përkatësi të ndryshme etnike, gjuhësore, dhe edukative. Folësit përfaqësohen nga dy gjinitë dhe grupmosha të ndryshme duke ofruar kështu një material interesant rreth varieteteve gjuhësore, gjuhës së trupit, dhe dallimeve që ekzistojnë në gjuhë sipas gjinisë, moshës dhe edukimit.

Nisur nga kjo ide, TED Talks janë përdorur si materiale për të ushtruar shkathtësinë e të dëgjuarit po ashtu për të shërbyer si mostër për përgatitjen e fjalimeve para klasës si auditor. Studentët më ekstrovert kanë përgatitur fjalimet e tyre të bazuara në formatin e TED Talks, si nga tematika ashtu edhe nga përmbajtja dhe kohëzgjatja, duke shërbyer kështu si grup eksperimental.

Fjalimet e përgatitura të studentëve janë të një spektri të ndryshëm tematik si: Të dëgjosh të tjerët; Martohu në nxitim! Pendohu në pushim! Si t'i vlerësojmë gjërat që i marrim si të



mirëqena? Depresioni, plagë që shtiremi së nuk e shohim; kur ke 100 probleme dhe ankthi është më i vogli prej tyre. Liderët e vërtetë nuk krijojnë pasues, ata krijojnë liderë. Behu mjek i vetvetes! Fjalimet publike dhe frika nga ato; Dhuna në familje mund t'i ndodhë çdokujt; Disa pjesë nga jeta ime; Ummm, më fal, harrova!; Je, çfarë hanë; Është në dorën tënde; Burrat vijnë nga Marsi, femrat nga Venusi; Teknologjia e ndryshon njerëzimin; Ne kemi vetëm një planet për të jetuar, kujdesuni për te!.

Këto 16 fjalime të prezentuara nga 13 femra dhe 3 meshkuj kanë zgjatur 182,35 minuta, gjithsej tri orë duke filluar nga ai më i shkurtri 4 minuta, deri të fjalimi më i gjatë 30 minuta. Transkriptet e fjalimeve përfshijnë 41 faqe me 23.372 fjalë dhe të njëjtat janë përmbledhur dhe janë trajtuar për analizë diskursi. Folësit kanë shkruar edhe ditarë rreth zgjedhjes së temës, përgatitjes së fjalimit dhe mbajtjes së tij. Studentët e pranishëm në auditor kanë dhënë informatën kthyesë mbi këto fjalime. Për më tepër, kemi bërë edhe interpretimin e gjuhës joverbale të folësve.

Grupi i kontrollit në anën tjetër që janë studentët më introvertë, iu është dhënë mundësia për të shkruar fjalimet e tyre. Studentët janë sugjeruar të flasin për një ide interesante që vlen të dëgjohet. Poashtu, këtyre studentëve u rekomandohet të shprehin lirshëm në fletën e bardhë duke qenë vetvetja dhe të shkruajnë për dobësitë apo dështimet e tyre. Studentët kanë ndarë histori shumë personale dhe të dhimbshme si: problemet e ndryshme, dhuna, ankthi, frika, depresioni, frika nga të folurit në publik, pabarazia gjinore, varfëria, papunësia etj.

Në këtë punim janë përmbushur qëllime të shumëfishta. Pra, përveç hulumtimit të rolit të këtyre fjalimeve në nxënien e gjuhës së dytë, qëllimi tjetër është që të analizohet gjuha e përdorur në këto fjalime në mënyrë që të identifikohen dallimet sipas gjinisë, moshës, edukimit dhe gjuhës. Qëllim tjetër i punimit është hulumtimi i përdorimit të fjalimeve TED në nxënien e gjuhës së dytë si aktivitet i të dëgjuarit. Perceptimi i gjuhës nga ana e studentëve kur folësit dallojnë sipas gjinisë, moshës, arsimimit dhe nëse gjuha angleze është gjuhë e tyre burimore ose jo. Qëllimi tjetër është hulumtimi nëse fjalimet TED të përdorura si aktivitete të të dëgjuarit i ndihmojnë studentët në përmirësimin e aftësive të të folurit gjatë mbajtjes së fjalimit. Një tjetër qëllim që nuk duhet neglizhuar është përdorimi i këtyre fjalimeve si mjete ndihmëse në trajnimin e studentëve për një performancë më të mirë të të folurit duke analizuar gjuhën e përdorur nga folësit si dhe gjuhën joverbale si mjete vizuale në lehtësimin e komunikimit.

Oratoria është gjithmonë e rëndësishme për të dëshmuar fuqinë dhe për të fituar përkrahjen. Në nxënien e gjuhës poashtu, të folurit është një nga sfidat më të mëdha për të kapërcyer, sepse njeriu mund të mësojë në qetësi, të dëgjojë të tjerët duke folur, por aktiviteti më i vështirë është të folurit si shkathtësi e performancës. Sipas këtij punimi, përdorimi i fjalimeve TED si aktivitete të të dëgjuarit iu mundëson studentëve kuptimin e gjuhës, përvetësimin e saj si dhe përdorimin e mostrave si mjete ndihmëse për të folurit në mënyrë kritike dhe argumentative meqë shumica e materialit të prezentuar në këto fjalime është diskurs argumentativ.

Në këtë punim janë parashtruar hipotezat se, TED Talks janë mjete të rëndësishme gjuhësore në lehtësimin e të kuptuarit e të dëgjuarit në nxënien e gjuhës së dytë. Poashtu, TED Talks shërbejnë si një mostër për përmirësimin e shkathtësive të të folurit gjatë prezentimeve të studentëve. Më tutje, sipas punimit, TED Talks janë përdorur si mjete vizuale që iu mundësojnë studentëve të përvetësojnë informata rreth qëndrimit, gjuhës joverbale, dhe ndërveprimit me audiencë gjatë prezentimit. Gjithashtu, TED Talks shërbejnë si teste të të dëgjuarit për matjen e kuptueshmërisë së studentëve për gjuhën e dytë. Poashtu, perceptimi i studentëve për gjuhën ndryshon varësisht nga moshja, gjinia, arsimimi dhe prapavija gjuhësore e folësit. Dhe në fund por jo me pak, ekzistojnë dallime në varietetet gjuhësore bazuar në moshë, gjini dhe origjinë të folësit.

Klasët kanë qenë të ndara në grupe eksperimentale dhe grupe kontrolli në mënyrë që të matet impakti i këtyre video-regjistrimeve si një ndihmesë për shkathtësitë e të dëgjuarit dhe të të folurit, ku rezultatet janë analizuar dhe krahasuar. Fjalimet TED të prezantuara janë procesuar në atë mënyrë që testet e kuptueshmërisë janë përpiluar që studentët të testohen.

Sa i përket shkathtësive të të folurit, studentët kanë studiuar shembujt nga TED Talks dhe kanë ushtruar fjalimin sipas modelit të caktuar. Hulumtimi që përfshin një spektër të gjerë videosh të prezentuesve të të dy gjinive, moshave të ndryshme, arsimimit të ndryshëm dhe nëse prezentuesi është folës burimor apo joburimor i gjuhës angleze, iu është ofruar studentëve si mostër për përgatitjen e fjalimeve

Një çështje tjetër e rëndësishme për t'u vëzhguar është impakti i këtyre fjalimeve si aktivitet i të dëgjuarit në nxënien e gjuhës së dytë duke vërtetuar se studentët që janë të ekspozuar në mënyrë

konstante ndaj këtyre materialeve tregojnë rezultate më të mira në nxënien e gjuhës, pasi janë testuar për kompetencë gjuhësore.

Pyetësorët si instrumente matëse janë përdorur për të dhëna kualitative dhe kuantitative, si dhe të dhënat janë analizuar thellësisht. Protokolet e vëzhgimit janë përdorur si metoda të vëzhgimit të studentëve gjatë aplikimit të shkathtësive të të folurit dhe të dëgjuarit në klasë poashtu. Teste të ndryshme janë përpiluar, duke përdorur fjalimet TED për të kuptuarit e të dëgjuarit si dhe studentët janë testuar në nxënien e gjuhës.

Të gjitha çështjet e përmendura më lart janë elaboruar dhe shqyrtuar me qëllimin e gjetjes së rezultateve nga pyetësorët , vëzhgimi, regjistrimet, dhe testimi. Është bërë një përpjekje e madhe që të paraqiten të dhënat dhe të interpretohen ato në tabela, si dhe janë bërë statistika të ndryshme në mënyrë që të paraqitet situatë më reale në nxënien dhe mësimdhënien e gjuhës, si dhe njohurinë metakognitive mbi gjuhën.

Ky punim doktrate duke qenë i natyrës kualitative dhe kuantitative ka një rëndësi të konsiderueshme për fushën e analizës së diskursit, studimeve gjinore, përvetësimit të gjuhës dhe metodologjisë së mësimdhënies.

Disertacioni i doktoratës është i përfshirë në 7 kapituj. Kapitulli i parë përmban hyrjen në studim, qëllimet dhe rëndësinë e studimit, hipotezat dhe pyetjet hipotetike si dhe arsyeshmërinë e punimit, si dhe rëndësinë e mësimdhënies së gjuhës.

Kapitulli i dytë përmban sfondin teorik ku trajtohet rëndësia e shkathtësive të të dëgjuarit, të shkruarit dhe të folurit në përvetësimin e gjuhës së dytë sipas qasjeve të ndryshme, procesi dhe procedurat e të dëgjuarit; mësimdhënia si pjesë e hulumtimit, poashtu edhe çështjet sociolinguistike që janë gjuha, gjinia dhe analiza e diskursit dhe e gabimeve.

Kapitulli i tretë përmban metodologjinë e hulumtimit që përfshin: metodologjinë, proceset, kohëzgjatjen dhe instrumentet matëse.

Kapitulli i katërt përmban: analizën dhe interpretimin e të dhënave duke filluar me përmbledhjet e fjalimeve, analizën e tyre të diskursit, informatat kthyesë të studentëve rreth fjalimeve, tematikën e fjalimeve të shkruara, ditarët e studentëve që kanë mbajtur fjalimet; interpretimi i

gjuhës joverbale të folësve si dhe përdorimi i TED Talks në shkrimin e përmbledhjeve si aktivitete të pasdëgjimit.

Kapitulli i pestë përmban testet rreth TED Talks që janë përdorur si material për dëgjim, audio fjalët që janë përdorur nga grupi kontrollues.

Kapitulli i gjashtë përmban interpretimin e pyetësorëve, kurse kapitulli i shtatë përmban përfundimin që del nga fjalimet e studentëve të bazuara në TED; analiza e diskursit dhe gabimeve; informatat kthyesë të studentëve; interpretimi i gjuhës joverbale të studentëve; fjalimet e shkruara të studentëve; ditarët e folësve për përvojën para dhe post-folëse; TED Talks janë shumë të rëndësishme për përmirësimin e të kuptuarit të dëgjuarit; Audio Talks për të kuptuarit e të dëgjuarit; TED Talks për të shkruarit e përmbledhjeve si post-aktivitete të dëgjuarit; Relacioni i studentëve me temat e zgjedhura; Pyetësorët; Preferencat e studentëve rreth moshës, gjinisë, dhe origjinës së folësit; TED Talks që shërbejnë si mostër për përmirësimin e të folurit; TED talks që shërbejnë si mjete vizuale për gjuhën joverbale. Punimi poashtu ka edhe shtojcën duke filluar nga faqja 244 deri në faqen 262.

**Fjalët kyçe: TED Talks, shkathtësitë e të dëgjuarit, të folurit, të shkruarit, nxënia e gjuhës, analizë diskursi, gjuhë joverbale,**